



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



Nr. 05/9655 / 2018

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenin 5 paragrafi c të Ligjit të Arsimit në Komunitet të Republikës së Kosovës Ligji nr. 03/L-068 të datës 21 Maj 2008, **Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018 të datës 20.07.2018 (Normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm)**, Nenit 20 të Ligjit për Arsimin Fillor të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë 04/L-032 të datës 29.08.2011, UA mbi verifikimin e diplomave dhe dokumentacionit tjetër të lëshuara nga BPrAL me Nr. 3/2010 të datës 16.04.2010 dhe UA 17/2009 të datës 28.08.2009 (Procedura e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë).

Drejtoria Komunale e Arsimit shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e kuadrit arsimor për vitin shkollor 2018/2019 në shkollat e Komunës së Hani të Elezit

Nr.	Niveli	Institucioni/ Shkolla	Vendi	Pozita	Zëvendësim
1	SHFMU	"Ilaz Thaçi"	Hani i Elezit	1. Një mësimdhënës/e për Histori	Me kohë të caktuar

I. Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë).
- Rezumeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat) duhet të jetë kopje e vërtetuar në Komunën e Hani të Elezit jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasys.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i tjerat jo profesionale nuk shqyrtohen,

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimorë:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara sipas **Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018 të datës 20.07.2018 (Normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm)**, si dhe akteve juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138). Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata

të pakualifikuar sipas këtyre Udhëzimeve Administrative nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

- III. Për vendin e lirë në institucione edukativo arsimore, kohëzgjatja e kontratës është me afat të caktuar, e cila do të definohet në kontratën e punës, por jo më gjatë se me datë 31.08.2019.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në Komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e Komunës së Hani të Elezit.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetën zyrtare, tabelën e shpalljeve dhe në veb faqen e Komunës së Hani të Elezit.

- IV. Intervista për mësimdhënës

Për këtë vend të punës, kandidatët do t'i nënshtrohen testit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Testi me shkrim mbahet më 10.12.2018 ora 11:00 ndërsa intervista me gojë mbahet të njëjtën ditë ora 14.00, vendi: zyra e takimeve në komunën e Hani të Elezit.

Data: 22.11.2018

